


 REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
 MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
 MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE
 MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY
 KABINETI I MINISTRI-KABINET MINISTRA-CABINET OF THE MINISTER

Nr. Prot: _____ Datum: _____
 Broj Prot: 191/01B Datum: 13.05.2015
 Prot No: _____ Date: _____
 Prishtinë / a


 REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
 MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
 MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE
 MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY
 SEKTORI I MINISTRI-SEKTOR MINISTRA-SECTOR OF THE MINISTER

Njesia Org: 01B Nr. Prot: _____
 Org. Jedinica: _____ Broj Prot: 1614
 Org Unit: _____ Prot No: _____
 Nr. i faqeve: _____ Datum: _____
 Dr. stranica: 7 Datum: 14.05.2011
 No. pages: _____ Date: _____
 Prishtinë / a



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
HASAN PRISHTINA



UNIVERSITETI I MITROVICËS
ISA BOLETINI

MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT

MES

MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË (MASHT)

UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" (UP)

DHE

UNIVERSITETIT TË MITROVICËS "ISA BOLETINI" (UMIB)

Duke pasur parasysh Vendimin e Kuvendit të Kosovës nr. P – 124 të datës 30 Maj 2013, për ratifikimin e Vendimit për themelimin e Universitetit Publik në Mitrovicë, të Qeverisë së Republikë së Kosovës nr. 02/118 të datës 06.03.2013 dhe Vendimit të MASHT nr. 09/76/B për formimin e Këshillit Drejtues, si dhe me kërkesë të Këshillit të Përkohshëm Drejtues të UMIB për fillimin e procesit të shpëputjes të Fakultetit të Gjeoshkencave dhe Teknologjisë dhe të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara (*njësi akademike e UP*), si dhe duke konsideruar nevojën e bashkëpunimit mbi bazën e barazisë dhe të përfitimit të ndërsjellë, u pajtuan si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi ka për qëllim të rregulloj statusin e njësive akademike të UP-së që gjinden në Mitrovicë respektivisht kalimin e Fakultetit të Gjeoshkencave dhe Teknologjisë dhe Fakultetit të Shkencave të Aplikuara në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", bartjen e të gjitha të drejtave të pronësisë ose posedimit që lidhen me pasuritë (asetet) dhe objektet që UP-ja i ka në Mitrovicë në emrin e UMIB-it, statusin e personelit akademik dhe administrativ, statusin e studenteve aktual në këto njësi akademike, shfrytëzimin e buxhetit të përbashkët të UP dhe UMIB, formimin e komisionit mbikëqyrës për zbatimin e marrëveshjes dhe të gjitha çështjet tjera që kanë të bëjnë me përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, në bazë të cilave UP dhe UMIB pajtohen t'i realizojnë.

Neni 2

Fushëveprimi

Palët në këtë marrëveshje janë pajtuar plotësisht që njësitë akademike të UP, të cilat gjinden në Mitrovicë, respektivisht Fakulteti i Gjeoshkencave dhe Teknologjisë dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara të kalojnë në UMIB.

Neni 3

Objektet dhe pasuritë – asetet

1. Pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme që janë të regjistruara ose të paregjistruara në emrin e UP “Hasan Prishtina” dhe që ndodhen aktualisht në shfrytëzim nga njësitë akademike në Mitrovicë, kalojnë në pronësi të UMIB-it.
2. UMIB-it i bartet e drejta e pronësisë ose posedimit për pasuritë (asetet) dhe objektet e UP-së të ndodhura në Mitrovicë.
3. UMIB në afat prej 2 muaj nga dita e lidhjes së kësaj marrëveshjeje, do t’ia dorëzojë UP-së regjistrin e aseteve të regjistruara, në mënyrë që UP-ja të bëjë ç’regjistrimin nga regjistri i mjeteve themelore dhe heqje dorë nga e drejta pronësore.

Neni 4

Personeli akademik

1. Personeli akademik (në marrëdhënie të rregullt pune me thirrje akademike, profesor, asistent, asistenti ri, lektor) i FGJT dhe FSHA në Mitrovicë konsiderohet personel i UP-së deri ditën e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.
2. Personeli nga pika 1, nga data 15.05.2015 bartet/transferohet me të drejta të njëjta në UMIB. Transferimi i personelit akademik nënkupton transferimin së bashku me numrin dhe buxhetin e planifikuar për paga dhe mëditje të personelit nga UP në UMIB. Në këtë mënyrë numri i personelit i paraparë me Ligjin mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës për UMIB-in rritet për numrin e transferuar të personelit nga UP-ja. Të gjitha këto ndryshime do të përfshihen në rishikimin e buxhetit të vitit 2015, respektivisht në Ligjin e Buxhetit të Kosovës.
3. Vendimet mbi thirrjet dhe kontratat e punës të nxjerra nga UP-ja, UMIB do t’i konsiderojë valide deri në afatin e përcaktuar në kontrata nga ana e UP-së.
4. UMIB-i do t’i sigurojë personelit akademik trajtim të njëjtë (akademik dhe financiar) ashtu siç e kishin në UP.

5. Bazë mbi numrin e personelit që transferohet nga UP-ja në UMIB do të merret numri i personelit të dy njësive akademike të UP-së në Mitrovicë sipas listës së pagave të datës 30.12.2013

Neni 5

Personeli administrativ

1. Personeli administrativ FGJT dhe FSHA në Mitrovicë me kontratë apo me akt emërim, konsiderohet personel i UP-së deri ditën e nënshkrimit të kësaj marrëveshje.
2. Përveç personelit si në pikën 1 të këtij neni, të drejtë përcaktimi për të qenë personel administrativ i UMIB, kanë edhe personeli i UP-së i ngarkuar me detyra në kuadër të FGJT dhe FSHA të UP-së në Mitrovicë. Personeli administrativ që i takon kësaj kategorie, në afat prej 15 ditësh pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, përkatësisht deri më 31.05.2015 duhet të deklarohet me shkrim nëse dëshiron të bëhet pjesë e personelit administrativ të UMIB-it.
3. Personeli administrativ i FGJT dhe FSHA në Mitrovicë, nga data 15.05.2015 bartet/ transferohet me të drejta të njëjta si personel administrativ në UMIB, ndërsa personeli si në pikën 2 të këtij neni, nga data 01.06.2015 bartet/ transferohet me të drejta të njëjta si personel administrativ në UMIB. Transferimi i personelit administrativ nënkupton transferimin së bashku me numrin dhe buxhetin e planifikuar për paga dhe mëditje të personelit nga Universiteti i Prishtinës në Universitetin e Mitrovicës. Në këtë mënyrë numri i personelit i paraparë me Ligjin mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës për UMIB-in rritet për numrin e transferuar të personelit nga UP-ja. Të gjitha këto ndryshime do të përfshihen në rishikimin e buxhetit të vitit 2015, respektivisht në Ligjin e Buxhetit të Kosovës.
4. Personeli administrativ i transferuar do të caktohet si personel i administratës të UMIB-it, në pajtim me kualifikimet, shkathtësitë, aftësitë profesionale dhe përvojën e fituar në punë, për plotësimin e pozitave - vendeve të punës të parapara sipas Rregullores mbi organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, përshkrimit të punëve dhe detyrave të punës për administratën e UMIB-it.
5. Pavarësisht nga ndërrimi i punëdhënësit, personelit të sipërpërmendur UMIB do t'i sigurojë trajtim të njëjtë me atë që kishte në UP.
6. Bazë për numrin e personelit që transferohet do të merret numri i të punësuarve në dy njësitë akademike të UP – së në Mitrovicë sipas listës së pagave të datës 31.12.2013

Neni 6 Studentët

1. Studentët e njësive akademike të UP-së (FGJT dhe FSHA në Mitrovicë), të regjistruar para vitit akademik 2013/14 nga data 01.10.2016 do të konsiderohen studentë të UMIB-it.
2. Studentët e degëve të Fakultetit Juridik, Fakultetit Ekonomik dhe të Fakultetit të Edukimit, qendra në Mitrovicë, të regjistruar në kuadër të UP-së në vitin akademik 2013/14, e të cilët nga vitit akademik 2015/16 nuk dëshirojnë të kalojnë si studentë të UMIB-it, do të transferohen në kuadër të fakulteteve përkatëse në qendrën e Prishtinës.
3. Për studentët e degëve të Fakultetit Juridik, Fakultetit Ekonomik dhe të Fakultetit të Edukimit të cilët përsërisin vitin, mund të transferohen në kuadër të fakulteteve përkatëse të UMIB-it ose në fakultetet përkatëse të UP-së në Prishtinë.
4. Të gjithë studentët e njësive akademike të UP-së (FGJT dhe FSHA në Mitrovicë dhe ish-SHLT dhe ish-FXM dhe ish-FSHTA në Mitrovicë) të cilët kanë diplomuar dhe ata të cilët diplomojnë deri më datë 30.09.2016 do të pajisen me diploma, diploma duplikat, certifikata, vërtetime dhe dokumentacion tjetër përcjellës nga UP. Diplomat do të nënshkruhen nga dekani aktual i njësisë akademik përkatëse të UMIB-it dhe nga rektori i UP-së.
5. Studentët të cilët i takojnë kategorisë si në pikën 4, e të cilët nuk arrijnë të diplomojnë deri më 30.9.2016 do të transferohen në programe të njëjta në kuadër të fakulteteve përkatëse të UMIB-it.
6. UMIB do t'i sigurojë kushtet akademike dhe infrastrukturore për të gjithë studentët që i takojnë kategorisë si në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, në mënyrë që ata t'i ndjekin dhe përfundojnë studimet në përputhje të plotë me kushtet dhe kriteret akademike, duke zbatuar plotësisht programet e akredituara.
7. Deri në përfundimin e studimeve, UMIB këta studentë do t'i trajtojë sipas të gjitha kriterëve akademike dhe kërkesave që dalin nga legjislacioni për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës dhe nga Deklarata e Bolonjës.
8. UMIB merr obligim për digjitalizimin e të dhënave për studentë dhe dokumentacionin sipas standardeve të kërkuara nga UP.

Neni 7

Dokumentacioni (librat, dosjet dhe dokumentacioni tjetër zyrtar) dhe arkiva

1. UMIB dhe njësitë akademike janë trashëgimtare të tërë dokumentacionit dhe arkivit të FGJT dhe FSHA në Mitrovicë, që përfshinë edhe dokumentacionin që është trashëguar nga ish-Shkolla e Lartë Teknike nga ish-Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë dhe ish-Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuar.
2. UMIB garanton dhe mbanë përgjegjësi të plotë për menaxhim cilësor dhe korrekt të dokumentacionit universitar.
3. UMIB, sipas kërkesës të UP-së lidhur me dokumentacionin e saj, detyrohet që çdo herë të vë në dispozicion të dhëna zyrtare, informata, dosje, libra dhe dokumentacion të caktuar zyrtar për nevoja të UP-së.
4. UMIB do të përgatisë dokumentacion të veçantë (formularë dhe dëshmi) që t'i transferojë UP-së të dhëna të besueshme dhe zyrtare.
5. UMIB dhe menaxhmenti i njësive akademike të saj, kanë detyrim për organizimin në planin administrativ, teknik dhe infrastrukturor të mësimit për të gjithë studentët që vazhdojnë studimet me programe të UP-së, nga viti akademik 2015/2016 e deri në diplomimin e tyre.

Neni 8

Shfrytëzimi i buxhetit

1. Për buxhetin e grumbulluar nga pagesat e studentëve si të hyra vetanake do të caktohet kufiri buxhetor mbi bazën e numrit të studentëve që kalojnë nga UP-ja në UMIB dhe i njëjti do të bartet në UMIB i cili më pas do të ketë të drejtën e alokimit të këtyre mjeteve. Të gjitha këto ndryshime do të përfshihen në rishikimin e buxhetit të vitit 2015, ndërsa do të shfrytëzohen nga viti akademik 2015/16.

Neni 9

Menaxhimi i aseteve, mirëmbajtja dhe sigurimi i objekteve të UMIB-it

1. Menaxhimi i aseteve, mirëmbajtja e tyre dhe sigurimi i objekteve do të kalojnë në kompetencë dhe financim të UMIB-it nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje.
2. Sipas nevojës UMIB-i do të shfrytëzojë kontratat kornizë, që UP-ja i ka të kontraktuara me kompanitë për shërbimet e sigurimit dhe mirëmbajtjes së pastërtisë, deri në përfundim të kontratës me operatorët aktual.

Neni 10
Fushat e bashkëpunimit

1. UP – ja do ta ndihmojë dhe do ta mbështesë UMIB-in në fazën e themelimit-konsolidimit, në fushat akademike dhe shkencore.
2. UP do të ndihmoj themelimin e UMIB-it, edhe përmes ofrimit të mundësisë për krijimin e partneritetit me të gjitha qendrat e organizuara në nivel të UP-së.
3. UP-ja këtë marrëveshje e konsideron afatgjatë dhe i obligon njësitë e veta akademike veçanërisht Fakultetin Juridik, Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin e Edukimit që këtë akt ta respektojnë maksimalisht.
4. UP-ja dhe njësitë akademike të saj do angazhohen si në planin akademik ashtu edhe me personel mësimor, sipas nevojës, të ndihmojnë zhvillimin e mësimin në UMIB.
5. UP-ja do të lejoj angazhimin e personelit të saj në kuadër të UMIB-it vetëm për mësimdhënësit të cilët nuk e plotësojnë normën e plotë apo mbinormën në kuadër të UP-ës, por jo më shumë se 6+6 orë në javë në të dyja institucionet.
6. Pika 4 dhe 5 e këtij neni realizohen sipas kërkesës më shkrim nga UMIB drejtuar UP-së.

Neni 11
Këshilli Mbikëqyrës i Marrëveshjes

1. MASHT, UP dhe UMIB, jo më larg se një muaj pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, do të formojnë Këshillin Mbikëqyrës, i cili do të mbikëqyrë zbatimin e kësaj marrëveshje.
2. Këshilli Mbikëqyrës do të përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, ku universitetet përfaqësohen nga sekretarët e përgjithshëm të universiteteve dhe një përfaqësues nga MASHT.
3. Përfaqësuesin e MASHT-it në këtë Këshill Mbikëqyrës e emëron Ministri.
4. Këshilli Mbikëqyrës ka kompetencë të mbikëqyrë zbatimin e kësaj marrëveshje dhe sipas nevojës të ofrojë zgjidhje, të cilat do të ndihmojnë ndarjen e këtyre dy institucioneve si edhe bashkëpunimin e qëndrueshëm ndërmjet tyre.
5. Në rast se gjatë zbatimit të marrëveshjes paraqiten vështirësi dhe paqartësi, Këshilli Mbikëqyrës gjen zgjidhje të pranueshme, në të kundërtën palët nënshkruese hartojnë ndryshime dhe plotësime të kësaj marrëveshje.

6. Këshilli Mbikëqyrës në fund të vitit kalendarik raporton me shkrim te palët nënshkruese të kësaj marrëveshjes për ecurinë e realizimit të marrëveshjes.
7. Këshilli Mbikëqyrës ka për obligim që të konstatoj se procesi i ndarjes ka përfunduar dhe për këtë hartohet raport me shkrim që nënshkruhet nga palët nënshkruese të marrëveshjes.
8. Mandati i Këshillit Mbikëqyrës përfundon në momentin kur palët konsiderojnë se nuk kanë çështje kontestuese.
9. Anëtarët e Komisionit mbikëqyrës, për punën e vet do të kompensohen nga institucionet përkatëse me nga 50 euro bruto për takim. Komisioni takohet sipas nevojës të palëve nënshkruese.

Neni 12

Interpretimi

1. Interpretimi i kësaj marrëveshjeje bëhet në pajtim me qëllimet e shprehura më sipër dhe në bazë të ligjeve të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
2. Të gjitha mangësitë, dy kuptimet, moskuptimet dhe mospajtimet që dalin nga kjo marrëveshje, interpretohen në mënyrë autentike nga MASHT duke u mbështetur në parimin e reciprocitetit dhe frymën e zhvillimit akademik-universitar me interes të përgjithshëm.

Neni 13

Ndryshimi dhe plotësimi i marrëveshjes

1. Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj marrëveshjeje mund të bëhet me pajtimin e të gjitha palëve nënshkruese.
2. Ndryshimet dhe/ose plotësimet duhet të jenë pjesë-shtojcë e kësaj marrëveshjeje.

Neni 14

Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshjeje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.
2. Marrëveshja nënshkruhet në gjashtë (6) kopje identike, nga dy (2) kopje për secilën palë të marrëveshjes, të cilat kanë forcë të njëjtë juridike.

Nënshkruar në Prishtinë, Republika e Kosovës me 13 maj 2015

Në emër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës

Z. Arsim BAJRAMI, ministër




Në emër të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”

Z. Ramadan ZEJNULLAHU, rektor




Në emër të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”

Z. Alush MUSAJ, rektor


